
REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQSOR
TIRANE

Nr.1277 AKTI

Nr.3221 VENDIMI

V E N D I M
“PËR MOSKOPETENCE LENDORE”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga :

GJYQTARE	FAHRIJE (BUDO) STRINGA
GJYQTARE	MIMOZA (KAJO) BRAHIMI
GJYQTARE	MIRANDA BEGAJ

Asistuar nga sekretare gjyqësore AURORA DINE, sot në dt.20.04.2010, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen civile që i përket:

PADITESE: **Bashkia Tirane**, perfaqesuar me autorizim nr.4835/3 Prot. date 25.05.2009 nga Znj.Natasha Kondi dhe Znj.Flora Kalaja.

TE PADITUR: **Keshili i Ministrave** perfaqesuar nga Avokati i Shtetit Z.Endri Kotherja,
Ministria e Ekonomise Tregetise dhe Energjetikes perfaqesuar nga Avokati i Shtetit prane kesaj ministrie Z.Artur Hysenaj,
Qendra Kombetare e Regjistrimit Tirane – ne mungese.

OBJEKTI: Shfuqizimin e VENDIMIT te KESHILLIT TE MINISTRAVE Nr.660 date 12.9.2007 “PER TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TE SHOQERIVE TE UJESJELLESVE DHE KANALIZIMEVE NJESIVE TE QEVERISJES VENDORE”;
Shfuqizimin e VENDIMIT te KESHILLIT TE MINISTRAVE Nr.678, date 3.10.2007 “PER NJE SHTESE NE VENDIMIN NR.271, DATE 9.5.1998 TE KESHILLIT TE MINISTRAVE “PER MIRATIMIN E STATUTIT TIP TE SHOQERIVE ANONIME SHTETERORE”;

Shfuqizimin e VENDIMIT te KESHILLIT TE MINISTRAVE Nr.677, date 3.10.2007 “PER DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NE VENDIMIN NR.642, DATE 11.10.2005 TE KESHILLIT TE MINISTRAVE PER KESHILLAT MBIKEQYRES TE SHOQERIVE ANONIME SHTETERORE”;

Pavlefshmerine e regjistrimeve te kryera ne QKR.

BAZA LIGJORE:-Nenet 31 e 324/a dhe 326/1 te K.Pr.Civile,

nenet 78, 92, 128 te Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite tregetare", i ndryshuar;
neni 26/3 i Ligjit nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".
Ligji nr.9901 date 14.04.2008 per "Tregetaret dhe shoqerite tregetare".

Gjykata pasi celi seancen gjyqesore te kesaj ceshtje civile, degjoi kerkesen e:
Avokatit te Shtetit perf.ligjor i Keshillit te Ministrave, i cili kerkoi nxjerrjen jashte juridiksionit ligjor te zakonshem te kesaj ceshtje civile;
Pala paditese Bashkia Tirane kerkoi mospranimin e kesaj kerkese;
Avokati i Shtetit perf.ligjor i M.E.T.E. kerkoi pranimin e kerkeses.
Gjykata pasi shqyrtoi kerkesen:

VEREN:

Se pala paditese Bashkia Tirane i eshte drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë-padinë e lartpërmendur me objekt:-

Shfuqizimin e VENDIMIT te KESHILLIT TE MINISTRAVE Nr.660 date 12.9.2007 "PER TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TE SHOQERIVE TE UJESJELLESVE DHE KANALIZIMEVE NJESIVE TE QEVERISJES VENDORE";

Shfuqizimin e VENDIMIT te KESHILLIT TE MINISTRAVE Nr.678, date 3.10.2007 "PER NJE SHTESE NE VENDIMIN NR.271, DATE 9.5.1998 TE KESHILLIT TE MINISTRAVE "PER MIRATIMIN E STATUTIT TIP TE SHOQERIVE ANONIME SHTETERORE";

Shfuqizimin e VENDIMIT te KESHILLIT TE MINISTRAVE Nr.677, date 3.10.2007 "PER DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NE VENDIMIN NR.642, DATE 11.10.2005 TE KESHILLIT TE MINISTRAVE PER KESHILLAT MBIKEQYRES TE SHOQERIVE ANONIME SHTETERORE";

Pavlefshmerine e rregjistrimeve te kryera ne QKR.

Sipas pales paditese Bashkia Tirane keto V.K.M. vijne ne kundrshtim me shume ligje, madje edhe me ato ligje ne zbatim te te cilave kane dale, duke:

1-vendosur kufizime ne ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave te njesive te qeverisjes vendore;

2-vendosur kufizime ne administrimin e sh.a. ujesjelles-kanalizime;

3-vendosur kufizime te te drejtave te personit juridik;

4-vendosur kufizime me ate nenligjore te funksioneve dhe kometencave si dhe pronesia dhe votimi.

Avokati i Shtetit, si perfaqesues i Keshillit te Ministrave kerkoi nxjerrjen jashte juridiksionit ligjor te zakonshem te kesaj ceshtje civile, me pretendimin se kjo ceshtje nuk mund te gjykohet nga gjykata e sistemit te zakonshem, por vetem nga Gjykata Kushtetuese, pas jane vendime te Keshillit te Ministrave me karakter normativ.

Ne lidhje me kete kerkese Avokati i Shtetit i eshte referuar nenit 326 te K.Pr.Civile, nenit 131 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise dhe Ligjit nr.8577 date 10.02.2000 "Per organizimin e Gjykares Kushtetuese te Republikes se Shqiperise".

dhe Avokati i Shtetit prane Ministrise se Ekonomise, Tregetise dhe Energjetikes i qendroi te njejtes kerkese per nxjerrjen jashte juridiksionit ligjor te zakonshem te kesaj ceshtje civile, por vetem nga Gjykata Kushtetuese.

Ndersa pala paditese Bashkia Tirane e kundershoi ne gjykim kete kerkese me pretendimin se keto akte administrative te Keshillit te Ministrave i drejtohen njesive te qeverisjes vendore dhe jane me karakter individual, qe do te thote sipas tyre se nuk jane me karakter normativ. Vetem nese do te ishin akte me karakter normative, do te ishte Gjykata Kushtetuese qe do te shqyrtoje kushtetueshmerine e tyre.

Gjykata pasi analizoi kerkesen cmon se ajo eshte e bazuar ne ligj, konkretisht ne nenin 326 te K.Pr.Civile, ne nenin 105 te K.Pr.Administrative, ne nenin 131 te Kushtetutes dhe ne Ligjin nr.8577 date 10.02.2000"Per organizimin e Gjykates Kushtetuese te Republikes se Shqiperise".

Neni 326 i K.Pr.Civile parashikon shprehimisht:"Nuk mund te ngrihet padi ne gjykate per: -aktet administrative te Keshillit te Ministrave dhe te institucioneve te tjera te administrates publike te nivelit qendror apo vendor qe kane karakter normativ, pervec kur ato cenojne te drejtat e njeriut dhe lirite themelore, si dhe interesa te tjera te personave juridike dhe fizike;

-aktet administrative te cilat sipas Kushtetutes jane ne kompetencen e Gjykates Kushtetuese".

Neni 131 i Kushtetutes sanksionon: "Gjykata Kushtetuese vendos per : c)pajtueshmerine akteve normative te organeve qendrore dhe vendore me Kushtetuten dhe me mareveshjet nderkombetare".

Ne Ligjin nr.8577 date 10.02.2000"Per organizimin e Gjykates Kushtetuese te Republikes se Shqiperise" ne Nenin 49 parashikohet shprehimisht:

1. Për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të Presidentit të Republikës, të Kryeministrit, të jo më pak se një të pestës të deputetëve dhe të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.
2. Këtë të drejtë e kanë edhe Avokati i Popullit, organet e qeverisjes vendore, organet e bashkësive fetare, partitë politike, si dhe organizatat e tjera, vetëm kur argumentojnë se çështja lidhet me interesat e tyre.

Ne Nenin 50 te ketij ligji parashikohet:

"Kërkesat në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, mund të paraqiten brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e tyre".

Gjithashtu ne Nenin 51 te ketij ligji parashikohet:

"Gjatë shqyrtimit të kërkesave të parashikuara nga nenet 49 e 50 të këtij ligji, Gjykata Kushtetuese vlerëson:

a)përmbajtjen e ligjeve dhe të akteve normative;

b)formën e ligjeve dhe të akteve normative;

c)procedurën për miratimin, shpalljen dhe hyrjen në fuqi të tyre".

Ligji nr. 9000 date 30.01.2003"Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Ministrave" Neni 28 parashikon:

*"Llojet e akteve te institucioneve te pushtetit ekzekutiv jane:
a,) akti normativ, qe eshte akti qe nxjerr Keshilli i Ministrave ne zbatim te nenit 116 te Kushtetutes;*

b) vendimi me karakter normativ, qe eshte akti nenligjor I Keshillit te Ministrave qe rregullon marrredhenie te percaktuara me ligj, duke vendosur rregulla te pergjithshme sjellje".

Në padinë për shqyrtimin e ligjshmërisë së një akti administrativ, gjykata verifikon së pari kompetencën lëndore dhe tokësore për gjykimin e mosmarrvëshjes së paraqitur dhe bën një vlerësim të të drejtës së saj për të shqyrtuar mosmarrvëshjen e paraqitur.

VKM Nr.660 date 12.9.2007 "PER TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TE SHOQERIVE TE UJESJELLESVE DHE KANALIZIMEVE NJESIVE TE QEVERISJES VENDORE" ka vendosur:

1. Transferimin e aksioneve të shoqerive shtetërore të ujësjellësve dhe kanalizimeve në pronesi të njesive të qeverisjes vendore, sipas lidhjeve 1 e 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Kur shoqeria e ujesjellesve dhe kanalizimeve mbulon me shumë se një njësi qeverisjeje vendore, bazuar në shitjen me pakicë, në marrëdhëniet tregtare me perdoruesit finale, aksionet e shoqerise, që transferohen, u kalojnë njesive te qeverisjes vendore perkatëse ne bashkepronesi, ku pjesa takuese e aksioneve të çdo njesie eshte ne perpjestim te drejte me numrin e popullsisë se asaj njesie, që mbulohet nga shoqeria e ujësjellësit dhe kanalizimeve.

3. Njesite e qeverisjes vendore, të cilave u transferohen aksionet e shoqerive te ujesjellesve dhe kanalizimeve sipas këtij vendimi, jane të detyruara, që, per një periudhë kohore prej jo me pak se dy (2) vjetësh nga data e bërjes efektive të transferimit të aksioneve.

a) te mos shesin aksionet e tyre te persona, fizikë ose juridikë, të tjerë, shtetërorë a private;
b) te mos kryejne ndarje te shoqerise, por ta mbajnë ate si një njësi ligjore të vetme operuese."

Nisur nga keto parashikime ligjore gjykata cmon se aktet objekt gjykimi jane vendime me karakter normativ, akte nenligjore te Keshillit te Ministrave qe rregullojne marrredhenie te percaktuara me ligj, duke vendosur rregulla te pergjithshme sjellje.

Ne keto kushte gjykata cmon se nuk ka kompetence lendore si gjykate e zakonshme per shqyrtimin e ketyre akteve normative, qe jane paraqitur ne kete objekt gjykimi.

Gjykata cmon se eshte Gjykata Kushtetuese qe vlerëson përmbajtjen e ketyre akteve normative te Keshillit te Ministrave.

Per sa me lart gjykata vendos te shpalle moskompetencen lendore te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, si gjykate e zakonshme per gjykimin e kesaj ceshtje administrative me paditese Bashkia Tirane.

PER KETO ARSYE :


Bazuar në nenin 154 dhe në nenin 154/a 4 të K.Pr.Civile.

VENDOSA:

Pranimin e kerkeses se Avokatures se Shtetit per Moskompetencen Lendore te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, si gjykate e zakonshme per gjykimin e ceshtjes administrative me nr.1277 Akti me paditese Bashkia Tirane.

- Shpenzimet gjyqësore sic jane bere.
- Kundër vendimit mund të bëhet ankim i vecantë në Gjykatën e Apelit Tiranë.
- U shpall në Tiranë dt.20.04.2010.

**SEKRETARE
AURORA DINE**



**GJYQTARE
FAHRIJE (BUDO) STRINGA**

